

Më
Dana

30-08-2018

P.nr.25/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1933-1-17 të datës 11.01.2018, për veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1933-1-17 të datës 11.01.2018, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 14.03.2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1933-1-17 të datës 11.01.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, me profesion instalues i ngrohjes, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetase i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 09.08.2017, rreth orës 19:00, në rrugën "Ahmet Kaqiku", te stacioni i autobusëve në Ferizaj, derisa i dëmtuari [REDAKTUAR] ishte duke e pritur autobusin për tu kthyer shtëpi, i pandehuri me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit dhe e ka sulmuar fizikisht duke e goditur me shqelm në shpinë dhe kokë, pa pëlqimin e tij,-

-me të cilën ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Te dëmtuarin [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon ne kontest civil.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1933-1-17 të datës 11.01.2018, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprë penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1933-1-17 të datës 11.01.2018, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: kallëzimi penal, deklarata e të dëmtuarit, raporti i oficerit, si dhe dokumentacionet e tjera të bashkangjitura në lëndë, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20€, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.25/18, me datë 14.03.2018

Zyrtarja ligjore
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale
Hakile Ilazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.